



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 700 Prot.

Tiranë, më datë 02.07.2020

**VENDIM**  
**Nr. 195, datë 09.06.2020**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 09.06.2020,

**VENDOSI:**

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin kërkimor-shkencor në vazhdim «Projekti “Harta Arkeologjike Nënujore e Bregdetit Shqiptar” 2020» drejtuar nga MA. Adrian Anastasi, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
    - Kërkime me karakter sondazhi në liqenin e Ohrit, siti Lin3;
    - Të vazhdojë dokumentimi grafik, fotografik dhe video i siteve prehistorike, në liqenet e Ohrit dhe të Prespës;
    - Për vitin 2020, pritet të rritet sipërfaqja nënujore e kërkimeve arkeologjike në Gjirin e Durrësit, Liqenet e Ohrit dhe Prespës si dhe të meren të dhënat e para nga kërkimet në Liqenin e Knallës, Shëngjin;
  2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
  3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Arta DOLLANI

KRYETAR  
Elva MARGARITI

